

# GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

Gjykata Supreme e Kosovës  
PKL.-KZZ. Nr. 82/2010  
Prishtinë  
25 janar 2011

## Aktgjykim

### Në Emër të Popullit

**Gjykata Supreme e Kosovës** në kolegjin e përbërë prej Gjyqtarit të EULEX-it Gerrit-Marc Sprenger si Kryetar i kolegjit, Gjyqtarit të EULEX-it Charles L. Smith III dhe Gjyqtarëve të Kosovës Nesrin Lushta, Emine Mustafa dhe Salih Toplica si anëtarë të kolegjit,

Dhe me Nexhmije Mezinin si procesmbajtëse,


Në lëndën penale me numër API-KZI 09/2009 kundër të pandehurit:

**Shyqeri Shala**, i biri i \_\_\_\_\_, i lindur më 24 tetor 1968 në \_\_\_\_\_, Komuna e \_\_\_\_\_, shqiptar kosovar, i martuar dhe ka gjashtë fëmijë, me vendbanim në \_\_\_\_\_, tregtar, me gjendje ekonomike mesatare, ka mbaruar shkollën e mesme, në paraburgim në qendrën e paraburgimit në Dubravë deri në lirimin tij nga akuzat nga Gjykata e shkallës së dytë, Gjykata Supreme e Kosovës më 21 korrik 2009

**I dënuar në shkallën e parë** me Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prizren në lëndën P. Nr. 155/2007 të datës 17 prill 2008, të regjistruar në Shkrimoren e Gjykatës së Qarkut në Prizren të njëjtën ditë, **i pandehuri është shpallur fajtor për këto vepra penale:**

[i] Sepse më 10 tetor 2005 rreth orës 16:20 në tregun e fshatit \_\_\_\_\_, komuna e Prizrenit, **Osman Zyberaj** duke vepruar në bashkëpunim si bashkëkryerës me **Shyqeri Shalën** me qëllim të privimit të qëllimshëm nga jeta një person tjetër përkatësisht H. \_\_\_\_\_, ka shtënë me qëllim dhe ka vrarë H. \_\_\_\_\_ në prani të personave të tjerë në mënyrë të dhunshme duke shfaqur mospërfillje të pamëshirshme për jetën;

Për kryerjen e veprës penale të **Vrasjes së rëndë**, në kundërshtim me Nenin 147, pika 5 e Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (KPPK), të kryer në bashkëpunim sipas Nenit 23 të KPPK-së, me një person tjetër, duke vrarë H. \_\_\_\_\_ më 10 tetor 2005 në fshatin \_\_\_\_\_, komuna e Prizrenit;



[ii] Sepse më 10 tetor 2005 rreth orës 16:20 në tregun e fshatit \_\_\_\_\_ komuna e Prizrenit, **Osman Zyberaj** duke vepruar në bashkëpunim si bashkëkryerës me **Shyqeri Shalën** me qëllim të tentativës së qëllimshme për të privuar nga jeta një person tjetër, përkatësisht N \_\_\_\_\_ ka shtënë qëllimisht dhe ka plagosur N \_\_\_\_\_ në prani të personave të tjerë në mënyrë të dhunshme duke shfaqur mospërfillje të pamëshirshme për jetën;

Për kryerjen e veprës penale të **Vrasjes në tentativë**, në kundërshtim me Nenin 147, pika 11 dhe Neni 20 i KPPK-së, të kryer në bashkëpunim, sipas Nenit 23 të KPPK-së me një person tjetër, duke tentuar ta vrasë N \_\_\_\_\_ më 10 tetor 2005 në fshatin \_\_\_\_\_;

[iii] Sepse më 10 tetor 2005 rreth orës 16:20 në tregun e fshatit \_\_\_\_\_, komuna e Prizrenit, **Osman Zyberaj** duke vepruar në bashkëpunim si bashkëkryerës me **Shyqeri Shalën** me qëllim të privimit të qëllimshëm nga jeta një person tjetër, përkatësisht H \_\_\_\_\_, dhe me qëllim të tentativës së qëllimshme për të privuar nga jeta një person tjetër përkatësisht N \_\_\_\_\_, qëllimisht ka shtënë në H \_\_\_\_\_ dhe në N \_\_\_\_\_, duke mbajtur në posedim dhe në shfrytëzim armën për të cilën nuk ka pasur autorizim për posedim dhe për përdorim;


Për kryerjen e veprës penale të **Mbajtjes në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve**, në kundërshtim me Nenin 328, par. 1 i KPPK-së, duke mbajtur në posedim dhe në shfrytëzim armën për vrasje dhe për vrasje në tentativë të vëllezërve \_\_\_\_\_ më 10 tetor 2005 në fshatin \_\_\_\_\_;

#### **Dhe është dënuar si më poshtë:**

I akuzuari është dënuar për veprën penale të **Vrasjes së rëndë** të kryer në bashkëpunim me dënim prej njëzet e pesë (25) vjet burgim [Neni 147, par. 5 dhe Neni 23 i KPPK-së]; për veprën penale të **Vrasjes në tentativë** të kryer në bashkëpunim me dënim prej njëzet e pesë (25) vjet burgim [Neni 147, par. 11; Nenet 20 dhe 23 të KPPK-së]; për veprën penale të **Mbajtjes në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve** [Neni 328 par. 1 i KPPK-së] me dënim prej gjashtë (6) vjetësh burgim dhe për shkak të **Mbajtjes në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve** [Neni 328 par. 2 i KPPK-së] me dënim prej tre (3) vjetësh burgim.

Dënimi unik prej 25 vjetësh burgim është shqiptuar nga Gjykata e shkallës së parë në pajtim me Nenin 71, par. 1 i KPPK-së duke llogaritur kohën e kaluar në paraburgim që nga data 19 prill 2007;

**Në shkallën e dytë** me aktgjykimin e ndryshuar të Gjykatës Supreme të Kosovës (Ap-Kz Nr. 481/2008), të datës 21 korrik 2009 dhe pas ankesës së mbrojtjes kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut të Prizrenit (P. Nr. 155/2007), të datës 08 gusht 2008, **Shyqeri Shala** u lirua nga të gjitha akuzat, kurse bashkë i pandehuri tij **Osman Zyberaj**, avokatët mbrojtës të të cilit kanë paraqitur ankesa po ashtu me kohë, u shpall fajtor i



vetëm dhe u dënua për **Vrasje të rëndë** në kundërshtim të Nenit 147 pika 11 e KPPK-së, të kryer në bashkëpunim nën Nenin 23 të KPPK-së, me një person tjetër, vranë H më 10 tetor 2005 në fshatin , komuna e Prizrenit; dhe 2) sa i përket cilësimit juridik të pikës 3, **Mbajtjes në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve** të Nenit 328 paragrafi 2 i KPPK-së, sepse kishte mbajtur në posedim armën më 10 tetor 2005 në fshatin , Komuna e Prizrenit;

**Zyra e prokurorit të Shtetit të Kosovës (ZPShK)** më 25 shkurt 2010 ka paraqitur me kohë një Kërkesë për Mbrojtje të Ligjshmërisë kundër Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës të datës 21 korrik 2008 (Ap.-Kz. Nr.481/2009). Aktgjykimi i shkallës së dytë veçanërisht është kundërshtuar sepse Gjykata Supreme e Kosovës nuk kishte zbatuar drejt dispozitat e Nenit 387 paragrafi 2 të KPPK-së sa përket vlerësimit të dëshmitëve në dispozicion, kur Gjykata e liroi të pandehurin Shyqeri Shala. Përveç kësaj, Gjykata Supreme e Kosovës kishte shkelur Nenin 424 paragrafin 1 dhe 4 të KPPK-së, që kërkon një Shqyrtim të ri Gjyqësor sa herë që dëshmitë e disa dëshmitarëve (në rastin tonë deklaratat e dëshmitarit N ) të mbledhura nga Gjykata e shkallës së parë janë çështje të kontestuara lidhur me vërtetimin e gjendjes faktike.

Prandaj, ZPShK-ja propozon që Aktgjykimi i shkallës së dytë përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale siç përcaktohet me Nenin 403 paragrafin 2 nënparagrafin 1 të KPPK-së lidhur me Nenin 387 paragrafin 2 dhe Nenin 424 paragrafin 1 dhe 4 të KPPK-së.


**Avokati mbrojtës i të pandehurit Shyqeri Shala**, me përgjigjen ndaj Kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë më 11 tetor 2010 propozoi që Kërkesa e ZPShK-së për mbrojtje të ligjshmërisë të hedhet poshtë si e papranueshme ose të refuzohet si e pabazuar.

Duke u bazuar në Aktgjykimin me shkrim të Gjykatës së Qarkut në Prizren në lëndën me numër P. Nr. 155/2007 të datës 17 prill 2008 (të paraqitur në Shkrimoren e kësaj Gjykate në të njëjtën ditë), Kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë e ZPShK-së, përgjigjen me shkrim të Avokatit mbrojtës dhe në shkresat përkatëse të lëndës dhe dokumentet e siç ishin të vlerësuara gjatë seancës së datës 18 janar 2011, së bashku me analizën e ligjit në fuqi, Gjykata Supreme e Kosovës, pas këshillimit më datë 18 janar 2011, lëshon këtë:

## AKTGJYKIM

**Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e paraqitur më 5 shkurt 2010 nga Zyra e Prokurorit të Shtetit të Kosovës kundër aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Ap.-Kz. Nr. 481/2008, të datës 21 korrik 2009, refuzohet si e pabazuar.**

**Shpenzimet e procedurës do të mbulohen nga buxheti i Kosovës.**



# ARSYETIM

## Historia Procedurale

1. Në pasditen e 10 Dhjetorit 2005 rreth ores 16:20 në tregu e gjelbert në fshatin Komuna e Prizrenit, dy kryerësit duke vepruar në marrëveshje si bashkë-kryerës u janë afruar qytetarëve Shqiptar të Kosovës, H dhe vëllait të tij N, të cilët ishin në proces për të futur veturën e tyre me qëllim të daljes nga tregu, në të cilin kishin qenë për pazare në atë kohë. Të dy kryerësit kanë drejtuar revolet e tyre në H, të cilën e kanë qëlluar dhe vrarë. Njëri nga dy kryerësit, pasi kishte qëlluar në H, drejtoi revolen e tij edhe në drejtim të N, i cili gjatë rrjedhës së ngjarjeve u plagos dhe më pastaj u shtrua në spital.

2. Dëshmitarët kanë identifikuar të pandehurin **Osman Zyberaj** si njërin nga gjuajtësit, dhe i cili menjëherë pas kësaj ishte vërejtur të hynte në veturën Opel Vectra bordo në anën e vozitësit, e cila ishte e parkuar në atë mënyrë që bllokonte veturën e viktimave, e si rrjedhojë u bënte atyre të vështirë të dilnin nga ai vend. Më pastaj, Opel Vectra në fjalë kishte dal nga fshati në drejtim të Gjakovës.

3. Më 12 Tetor 2005 Prokurori Publik i Qarkut të Prizrenit paraqiti një Aktvendim për Fillimin e Hetimeve kundër **Osman Zyberaj** dhe kryerësit të dytë të pretenduar Shyqeri Shala. Urdhëri për arrestimin e tyre ishte lëshuar nga Gjyqtari i Procedurës Paraprake i Gjykatës së Qarkut të Prizrenit në të njejtën ditë. Më 19 Prill 2007 **Osman Zyberaj** ishte arrestuar nga Policia dhe ishte gjetur në posedim të një revolveri të tipit “Amadeo Rossi S.A. 0.38 Specialë”, për të cilin nuk kishte leje. Nga atëherë ai ishte paraburgosur vazhdimisht.

4. Si kryerës i dytë i pretenduar, **Shyqeri Shala** ishte arrestuar më 23 Maj 2007 pa incident nga Polica e UNMIK-ut dhe ishte paraburgosur sipas propozimit të Prokurorit Publik të Qarkut bazuar në aktvendimin e Gjykatës së Qarkut të Prizrenit në të njejtën ditë (Hep Nr 52/07).

5. Më datën 16 Korrik 2007 Prokurori Publik i Qarkut në Prizren hartoi aktakuzën kundër të pandehurve **Osman Zyberaj** dhe **Shyqeri Shala** (PP 230/2005), e cila ishte paraqitur në Gjykatën e Qarkut në Prizren më 17 Korrik 2007. Të dy të pandehurit ishin akuzuar për veprat penale **Vrasje e Rëndë** e kryer në Bashkë-kryerje [Neni 147 paragrafi 5 dhe Neni 23 i KPPK]; **Tentim Vrasje** e kryer në Bashkë-kryerje [Neni 147 paragrafi 11; Nenet 20 dhe 23 të KPPK]; **Mbajtje në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve** [Neni 328 paragrafi 1 i KPPK] dhe i pandehuri **Osman Zyberaj** i vetëm po ashtu për **Mbajtje në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve** [Neni 328 paragrafi 2 i KPPK].

6. Aktakuza ishte konsoliduar me aktvendimin e Konfirmimit të Gjykatës së Shkallës së Parë (KA 112/2007) më 30 Gusht 2007.



7. Seanca e hapur e Shqyrtimit Gjyqësor kundër **Osman Zyberaj** dhe **Shyqeri Shala**, i cili përbënte nëntë (9) seanca në total në mes të 31 Janarit dhe 17 Prillit 2008 pjesërisht ishte mbajtur në lokalet e Gjykatës së Qarkut në Prizren dhe – duke pasur në konsideratë gjendjen shëndetësore të pandehurit Osman Zyberaj – në disa pjesë të tjera në sallën e gjyqimit të ndërtesës së Burgut të Dubravës. Aktgjykimi i fajësis për **Vrasje të Rëndë** në shkelje të Nenit 147 paragrafët 4, 5 dhe 8 të KPPK dhe **Tentim Vrasje** në shkelje të Nenit 147 paragrafi 11 dhe Neni 20 i KPPK, të dyja të kryera në Bashkë-kryerje sipas Nenit 23 të KPPK, dhe për **Mbajtje në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve** në shkelje të Nenit 328 paragrafi 1 i KPPK kundër dy të pandehurve si edhe kundër të pandehurit Osman Zyberaj i vetëm për **Mbajtje në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve** në shkelje të Nenit 328 paragrafi 2 i KPPK ishte shpallur më 17 Prill 2008 duke shqiptuar denim unik prej 25 (njëzet e pesë) viteve burgim kundër secilit të pandehur.

8. Gjatë shqyrtimit gjyqësor, Gjykata e Shkallës së Parë kishte marrë në pyetje të akuzuarin, **Osman Zyberaj** dhe **Shyqeri Shala**. Pastaj dëshmitarët e mposhtëm ishin marrë në pyetje: V dhe S të cilët ishin në tregun e gjelbërt në Xërxë kur ishin kryer aktet kriminale në fjalë, Polici i SHPK-së L dhe ish Policja e SHPK-së F, të cilët e kanë hetuar vendin e ngjarjes dhe kanë marrë pjesë në hetime dhe autopsi në lidhje me gjurmimin dhe djegien e trupit të vdekur të viktimës H në Rahovec disa ditë më pas, viktimë N, Policët Ndërkombëtar R i cili ishte caktua për të monitoruar dhe këshilluar në rastin e vrasjes së H dhe E, i cili ishte i përfshirë në arrestimin e të pandehurit **Osman Zyberaj** më 19 Prill 2007, Polici i SHPK-së I i cili ishte përfshirë si ekspert i balistikës në hetimet në lidhje me armën e gjetur të **Osman Zyberaj** dhe kornizat e gëzhojes dhe kokat e plumbit të gjetura në vendin e krimit, gazetari i “Lajmit” Q, i cili ishte në vendin e ngjarjes menjëherë pas gjuajtjes dhe i cili – bazuar në informacionet të cilat i ishin dhënë përmes thirrjes telefonike – kishte botuar artikullin në gazetë më 14 Tetor 2005, e në këtë mënyrë duke treguar emrat e dy viktimave dhe se të pandehurit **Osman Zyberaj** dhe **Shyqeri Shala** do të ishin kryerësit, Patologu i Autopsis Dr. A, e cila e ka bërë autopsin e H, Kirurgu Ortopedik dhe Traumatologu Dr. D, e cili e kishte trajtuar N, Policët e SHPK-së H, G X, B dhe Ru, Be, të cilët të gjithë kanë qenë të përfshirë në hetimin e krimit; Sh, i cili ishte punëtor në autolarje në dhe Xh, i cili punon si shitës afërt tregut në dhe të cilët që të dy e kanë parë **Shyqeri Shala** afër tregut në ditën e gjuajtjes, si edhe Bu, gruaja e të pandehurit **Osman Zyberaj**.

09. Bazuar në këtë dëshmi, Gjykata e Shkallës së Parë ka vërtetuar gjendjen faktike, e cila ka shpjeguar në dënimet si janë theksuar më parë. Bazuar në konstatimet e saj, më 17 Prill 2008, Gjykata e Qarkut ka lëshuar Aktgjykimin dhe e ka shpallur të akuzuarin fajtor për veprat penale të renditura më herët nga pikat [i] deri në [iv]. Si pasojë, Gjykata ka shqiptuar dënimet mbi të akuzuarin sikurse poashtu janë specifikuar më lart.



10. Aktgjykimi ishte ankimuar në kohë, edhe nga Avokatët Mbrojtës të pandehurit **Osman Zyberaj** e edhe nga Avokati Mbrojtës i **Shyqeri Shalës**, i fundit më 11 Gusht 2008.

11. Më 29 Tetor 2008, Avokati Mbrojtës Ethem Rogova ka përcjellur në Gjykatë një letër të pandehurit **Osman Zyberaj** dhe ka kërkuar t'i bashkëngjitet në ankesë. Në mesin e të tjerave, i pandehuri Osman Zyberaj në këtë letër ka deklaruar se ai vet e kishte vrarë viktimën H dhe kishte plagosur vëllain e tij N dhe se ka vepruar i vetëm.

12. Më datën 01 Dhjetor 2008, ZPSHK dha një mendim sipas Nenit 409 paragrafi 2 i KPPK duke propozuar refuzimin e të gjitha ankesave si të pabaza dhe jo meritore. Prokurori Publik nuk kishte bërë ankesë.


13. Më 21 Korrik 2009, pas dorëzimit të shkresave të lëndës te EULEX-I në Janar 2009, Gjykata Supreme e Kosovës ka mbajtur një séance ankese në pajtim me Nenin 410 të KPPK, në të cilën ishin dëgjuar paraqitjet e bashkë-të-pandehurit **Shyqeri Shala** dhe Avokatëve të tij Mbrojtës Rexhep Hasani dhe Hazer Susuri.

Vec kësaj, ishte lexuar edhe kërkesa e të pandehurit **Osman Zyberaj** e datës 25 Tetor 2008 e bashkangjitur në ankesën e Avokatëve Mbrojtës si edhe paraqitjet e Avokatëve Mbrojtës të pandehurit **Osman Zyberaj**, Av. Ruzhdi Gashi, Av Ethem Rogova dhe Av Fatmir Celina e po ashtu edhe paraqitjet e të pandehurit **Osman Zyberaj** si edhe mendimi i ZPSHK.

14. Më datën 21 Korrik 2009 paneli i ankesave i Gjykatës Supreme të Kosovës ka shqiptuar Aktgjykimin e tij (Az.-Kz. 481/2008), me të cilin i pandehuri **Shyqeri Shala** ishte liruar nga të gjitha akuzat për shkak të mungesës së dëshmive.

15. I pandehuri **Osman Zyberaj** ishte shpallur fajtor, por ankesat e tij ishin pranuar pjesërisht sipas kualifikimit ligjor nën pikat 1 dhe 2 të Aktgjykimin të Shkallës së Parë, që ishte kualifikuar si Vrasje e Rëndë në shkelje të Nenit 147 paragrafi 11 i KPPK, si edhe sipas kualifikimit ligjor nën pikën 3 të Aktgjykimin të Shkallës së Parë, duke deklaruar se i pandehuri **Osman Zyberaj** kishte kryer vetëm veprën penale **Mbajtje në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve** në shkelje të Nenit 328 paragrafi 2 i KPPK. Për pjesët e mbetura ankesat ishin refuzuar dhe Aktgjykimi i Shkallës së Parë ishte konfirmuar.

16. Më 25 Shkurt 2010 **Zyra e Prokurorit të Shtetit të Kosovës (ZPSHK)** në kohë ka paraqitur Kërkesën për Mbrojtje të Ligjshmërisë kundër Aktgjykimin të Gjykatës Supreme të Kosovës të datës 21 Korrik 2008 (Ap.-Kz.No.481/2009). Aktgjykimi i Shkallës së Dytë në veçanti ishte atakuar sepse Gjykata Supreme e Kosovës nuk kishte aplikuar dispozitat e Nenit 387 paragrafi 2 i KPPK si duhet në lidhje me vlerësimin e dëshmive në dispozicion, kur e kishte liruar të pandehurin Shyqeri Shala. Për më tepër, Gjykata Supreme e Kosovës kishte shkelur Nenin 424 paragrafi 1 dhe 4 i KPPK, e që do të kërkonte një Shyqërtim të ri Gjyqësor kur do që dëshmia e disa dëshmitarëve (në rastin



në fjalë deklarata e dëshmitarit N. ) e mbledhur nga Gjykata e Shkallës së Parë të ishte çështje diskutimi në lidhje me vërtetimin e gjendjes faktike të çështjes .

Prandaj, ZPSHK-ja propozon që të konstatohet se aktgjykimi i shkallës së dytë përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale siç përcaktohet me nenin 403 paragrafin 2 nënparagrafin 1 të KPPK-së në lidhje me nenin 387 paragrafin 2 dhe nenin 424 paragrafët 1 dhe 4 të KPPK-së.

17. **Avokati mbrojtës i të pandehurit Shyqeri Shalës**, në përgjigjen ndaj kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë të 11 tetorit 2010, propozon që kërkesa e ZPSHK-së për mbrojtjen e ligjshmërisë të hedhet poshtë ose të refuzohet si e pabazuar.

## GJETJET E GJYKATËS

### **A. Shkelje substanciale e dispozitave të Procedurës Penale**

18. ZPSHK-ja e ka kundërshtuar aktgjykimin e shkallës së dytë për shkak se Gjykata Supreme e Kosovës kishte shkelur nenin 403 paragrafin 2 nënparagrafin 1 të KPPK-së.


#### **I. VLERËSIMI I DËSHMIVE NË DISPOZICION SIPAS NENIT 387 TË KPPK-SË**

19. Në veçanti, kontestohet që Gjykata Supreme e Kosovës nuk e ka aplikuar dispozitën e nenit 387 paragrafin 2 të KPPK-së në mënyrë të duhur sa i përket vlerësimit të dëshmive në dispozicion, kur Gjykata e ka liruar të pandehurin **Shyqeri Shalën**.

20. Pas analizimit të kujdesshëm të dispozitave përkatëse të ligjit si dhe të gjykimin të Gjykatës Supreme të Kosovës, ky kolegji gjen se në lëndën në fjalë gjykata e shkallës së dytë nuk e ka anashkaluar dispozitën e nenit 387 paragrafin 2 të KPPK-së në dëm të procedurës së duhur penale dhe prandaj, nuk është konstatuar shkelja e nenit 403 paragrafit 2, nënparagrafit 1 të KPPK-së, që do ta arsyetonte pohimin se aktgjykimi përkatës i shkallës së dytë përmban shkelje esenciale të ligjit të procedurës penale.

21. Neni 387 përcakton si në vijim:

- (1) *Gjykata e bazon aktgjykimin vetëm në faktet dhe provat e proceduara në shqyrtimin gjyqësor.*
- (2) *Gjykata detyrohet që me ndërgjegje të vlerësojë çdo provë një nga një dhe në lidhje me provat tjera dhe në bazë të vlerësimit të tillë të nxjerrë përfundim nëse fakti konkret është provuar.*



22. Pasi që nuk është e qartë vetëm nga formulimi i nenit 387 të KPPK-së, nëse zbatimi i dispozitës është i kufizuar vetëm për gjykatat e shkallës së parë apo vlen për të gjitha instancat, ligji ka nevojë që të interpretohet.

(1) Një **interpretim gramatikor** i ligjit do të mundësonte edhe njërin edhe tjetrin interpretim, pasi që ligji nuk përmend në mënyrë specifike asnjë kufizim në fazat e procedurës, por flet vetëm për “*gjykatat*”.

(2) Nën **aspektin sistematik** duhet të përmendet se dispozitat përkatëse mbi nxjerrjen e aktgjykimit janë përcaktuar me Kapitullin XXXV të KPPK-së dhe prandaj i takojnë Pjesës së Katërt të KPPK-së, e cila e rregullon “*shqyrtimin gjyqësor dhe aktgjykimin*”. Kjo mund të na bëjë të mendojmë se të gjitha këto dispozita vlejné vetëm për procedurat në nivelin e shkallës së parë. Në veçanti, neni 319 paragrafi 2 i KPPK-së në mënyrë të qartë përcakton se “*Kryetari i trupit gjykues cakton shqyrtimin gjyqësor posa aktakuza të merr formë të prerë*”, që natyrisht i referohet shkallës së parë.


Në anën tjetër, gjithashtu edhe instancat tjera mund të vendosin me aktgjykim. Kjo në veçanti mund të lexohet në nenin 423 të KPPK-së, sipas të cilit “*Gjykata e shkallës së dytë me aktgjykim refuzon ankesën si të pabazë...*”. Gjithashtu, Gjykata Supreme e Kosovës vendos me aktgjykim për secilën kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë, siç është përcaktuar me nenin 456 të KPPK-së për vendimin mbi refuzimin e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë, si dhe me nenin 458 të KPPK-së për vendimet mbi anulimin e aktgjykimit të kundërshtuar.

Pasi që vetëm Pjesa e Katërt e rregullon aktgjykimin, do të ishte e çuditshme të përfundohet se këto dispozita janë të lidhura vetëm me shkallën e parë por që të gjitha instancat tjera të cilat gjithashtu mund të vendosin me aktgjykim janë lënë pa asnjë dispozitë të zbatueshme se si të procedohet në këto raste. Prandaj, pozita e nenit 387 të KPPK-së në kontekstin e Pjesës së Katërt të ligjit në fjalë tregon se rregullat mbi nxjerrjen e aktgjykimeve gjithashtu vlejné edhe në fazën e ankesës.

(3/4) Pasi që nuk kemi qasje në asnjë dokument mbi **motivet e ligjit**, pyetja për **qëllimin e ligjit** mund të shfrytëzohet si një mjet shtesë i interpretimit. Është mjaft e qartë që qëllimi i nenit 387 paragrafit 2 të KPPK-së është që të sigurohet që secila provë të vlerësohet në mënyrë të duhur nga gjykata përkatëse qoftë veç e veç qoftë në kontekstin e të gjitha provave tjera të pranueshme. Kjo gjithashtu vlen edhe për gjykatën e shkallës së dytë që në veçanti të sqarohet nga neni 412 paragrafi 1 i KPPK-së sipas të cilit “*Shqyrtimi para gjykatës së shkallës së dytë mbahet vetëm kur është e nevojshme që, për shkak të vërtetimit të gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike, të merren prova të reja ose të përsëriten provat e marra më parë dhe kur ekzistojnë shkaqe të arsyeshme që lënda të mos i kthehet gjykatës së shkallës së parë në gjykim të sërishëm*”.

Duke u nisur nga kjo, është mjaft e qartë se gjykata e shkallës së dytë mund të marrë prova gjithashtu, por nëse vepron në atë mënyrë, atëherë detyrohet që t’i respektoj të njëjtat rregulla sikur gjykata e shkallës së parë, e që në këto raste ajo që duhet të zëvendësohet nga Gjykata e Apelit.

Prandaj, mund të konstatohet si rregull që – kur gjykata e shkallës së dytë vendosë që ta zëvendësoj vlerësimin e provave të bërë nga gjykata e shkallës së parë – ajo duhet të



marrë prova drejtpërdrejtë gjatë shqyrtimit në vend të zëvendësimit të vlerësimit përkatës vetëm në bazë të shkresave të lëndës, në veçanti kur provat në fjalë janë deklaratat e dëshmitarëve.

23. Për më tepër, sipas interpretimit të dytë Gjykata Supreme e Kosovës ka nxjerrë disa aktgjykime në rastet kur kolegji për ankesa kishte vendosur të mos pranonte asnjë dëshmi të re. Në të gjitha këto raste, Gjykata Supreme ka përcaktuar që konstatimet dhe vlerësimet e kolegjit duhet të konsiderohen detyrues për instancën e radhës. Në veçanti në lëndën e personave **Vladimir Ukaj, Robert Sylaj dhe Sabri Islami** (Ap-Kz 428/2007, të datës 28 maj 2007) Gjykata Supreme ka sqaruar se:

*“Gjykata Supreme e Kosovës duhet patjetër të pajtohet me vlerësimin e trupit gjykues lidhur me besueshmërinë e dëshmitarëve të cilët janë paraqitur dhe kanë dëshmuar personalisht para tyre. Nuk është e pëlqyeshme për Gjykatën Supreme të Kosovës të merr nëpër këmbë vlerësimin e trupit gjykues lidhur me besueshmërinë e këtyre dëshmitarëve nëse nuk ka baza të forta për diçka të tillë [...]” (faqja 24 e versionit në gjuhën angleze).*


Ky gjykim është përsëritur në lëndën e **Jeton Kiqinës** (Ap-Kz 84/2009, të datës 3 nëntor 2009), në të cilën Gjykata Supreme e Kosovës ka konstatuar se:

*“[...] nuk është në kompetencë të kolegjit për ankesa as nuk ka mundësi faktikisht të zëvendësojë konstatimet e Gjykatës së shkallës së parë me vlerësime të veta, sidomos jo pa marrë sërish të gjitha dëshmitë” (faqja 19 e versionit në gjuhën angleze).*

24. Megjithëkëtë, në lëndën në fjalë gjendja është krejt ndryshe. Gjykata e shkallës së dytë ka arritur në konstatimin se vlerësimi i deklaratave të dëshmitarit N ashtu siç është bërë nga Gjykata e shkallës së parë do të ishte e diskutueshme. Për më tepër, disa dëshmi rrethanore, në veçanti thirrja telefonike e pranuar nga gazetari Q

dy ditë pas krimeve si dhe deklaratat e disa prej dëshmitarëve që i pandehuri **Shyqeri Shala** ishte parë pasdite në ditën kur ishin kryer krimet, nuk do të ishin të mjaftueshme për ta dënuar, përkundër faktit se prania e të pandehurit **Shyqeri Shala** pikërisht në kohën kur është bërë vrasja, nuk është vërtetuar në tërësi duke i hequr të gjitha dyshimet.

Vlerësimi përkatës i Gjykatës së shkallës së dytë mund të gjendet në Aktgjykimin e datës 21 korrik 2009 (Ap-Kz 481/2008) në faqet 22-25 të versionit në gjuhën angleze. Gjykata e shkallës së dytë është e mendimit se përkundër faktit se identifikimi i të pandehurit **Shyqeri Shala** nga dëshmitari N është bërë dy vjet pasi ka ngjarë krimi dhe raporti policor i datës 13 tetor 2005 nuk përmend fare emrin e të pandehurit, nuk kishte dëshmi që **Shyqeri Shala** kishte poseduar ndonjëherë armë zjarri. Për më tepër, gjyqtari i shkallës së parë kishte harruar të merrte parasysh faktin që i pandehuri **Shyqeri Shala** nuk kishte motiv dhe nuk kishte marrë parasysh alibinë e **Shyqeri Shalës** të dhënë nga dëshmitarët J, Sh dhe Xh



Pastaj Gjykata e shkallës së dytë në Aktgjykimin e saj analizon dëshmitë, mbi të cilat Gjykata e shkallës së parë ka mbështetur dënimin e **Shyqeri Shalës**. Kolegji për ankesa arrin në përfundimin se ka dyshime të arsyeshme mbi identifikimin e qitësit të dytë si **Shyqeri Shala** siç është bërë nga dëshmitari N. Gjatë marrjes së tij të parë në pyetje më 11 tetor 2005, dëshmitari kishte përshkruar qitësin e dytë në detaje por kishte deklaruar se nuk kishte mundur ta identifikonte, përderisa gjatë intervistës së dytë më 27 tetor 2005 ai e kishte përshkruar atë dhe kishte deklaruar se familja i kishte thënë se ai person është **Shyqeri Shala**. Herën e tretë më 8 korrik 2008 dëshmitari kishte identifikuar **Shalën** në mesin e fotove të rreshtuara por kishte theksuar se nuk ishte krejt i sigurt vetëm në bazë të fotografisë. Vetëm gjatë shqyrtimit gjyqësor ai kishte identifikuar **Shalën** në mënyrë të qartë, kur ai ishte i pranishëm në sallën e gjyqimit, së bashku me një numër shumë të vogël pjesëmarrësish të tjerë në atë gjykim.


Edhe pse **Shyqeri Shala** asokohe kishte në pronësi një Opel Vectra ngjyrë “burgundi” (e përafërt me vjollcën), siç është vlerësuar nga gjyqtari i shkallës së parë dhe e ngjashme me veturën e lidhur me këto krime, kjo veturë e **Shalës** nuk është gjetur kurrë nga policia.

Edhe pse, telefonatat e zhvilluara ndërmjet telefonave mobilë të **Shyqeri Shalës** dhe **Osman Zyberajt** janë regjistruar (incizuar) para se të kryheshin krimet, as përmbajtja e këtyre bisedave telefonike as vendndodhja e këtyre dy telefonave në kohën kritike nuk dihet.

Thirrja telefonike e pranuar dy ditë pas të shtënave nga gazetari Q – edhe pse kallëzimi i dëshmitarit do të ishte i besueshëm – nuk do të mjaftonte për ta dëshmuar përgjegjësinë e **Shyqeri Shalës**.

Në fund, disa dëshmitarë kanë deklaruar se **Shyqeri Shala** ka qenë i pranishëm pasdite në ditën kur janë bërë krimet. Megjithatë, dëshmitari Xh kishte deklaruar se **Shyqeri Shala** ishte nisur nga për në Gjakovë dhe nuk është vërtetuar nëse **Shala** ka qenë apo jo i pranishëm në momentin e vrasjes.

25. Ky kolegji konstaton se Gjykata e shkallës së dytë në lëndën në fjalë ka bërë vlerësimin e saktë të secilës provë veç e veç, madje deklaratat e të gjithë dëshmitarëve përkatës janë marrë parasysh pa i marrë në pyetje sërish këta dëshmitarë një nga një, edhe pse kjo e dyta do të kishte qenë mënyrë më e mirë dhe më e qartë për rishqyrtimin e dëshmive të kontestueshme. Në veçanti, nuk ka pasur nevojë që të dëgjohet dëshmitari N për të dytën herë, sepse përkundër kundërthënieve ndërmjet disa nga deklaratat e tij lidhur me identifikimin apo jo të **Shyqeri Shalës** si njërit prej kryerësve të veprës edhe një pjesë e dëshmive rrethanore të mbledhura në dëm të **Shyqeri Shalës** ose nuk janë mbledhur fare nga policia dhe kështu nuk janë vërtetuar deri në atë masë që do të justifikonte shpalljen e **Shalës** fajtor, ose nuk kanë qenë aq të fuqishme sa për ta mbyllur zinxhirin e dëshmive në dëm të të akuzuarit. Për këtë arsye, Gjykata e shkallës së dytë me të drejtë ka zbatuar parimin *in dubio pro reo* siç përcaktohet me Nenin 3, par. 2 të KPPK-së dhe ka liruar **Shyqeri Shalën** nga të gjitha akuzat.



26. Në veçanti, vetura e **Shyqeri Shalës** nuk është gjetur kurrë nga policia dhe për më tepër përmbajtja e bisedës telefonike ndërmjet **Shyqeri Shalës** dhe **Osman Zyberajt** pak kohë para vrasjes mbetet e panjohur.

## II. KEQINTERPRETIMI I NENIT 424 PARAGRAFIT 1 DHE 4 TË KPPK-së

27. Për më tepër, sipas ZPSHK-së, Gjykata Supreme e Kosovës ka shkelur nenin 424 paragrafin 1 dhe 4 të KPPK-së, që kërkon një Shqyrtim të ri Gjyqësor sa herë që dëshmitë e disa dëshmitarëve (në rastin tonë deklaratat e dëshmitarit N ) të mbledhura nga Gjykata e shkallës së parë janë çështje të kontestuara lidhur me vërtetimin e gjendjes faktike .

28. Ky panel konstaton se neni 424 paragrafët 1 dhe 4 të KPPK-së nuk është keqinterpretuar nga gjykata e shkallës së dytë kështu që neni 403, paragrafi 2, pika 1 e KPPK-së nuk është marr parasysht.


Neni 424 i KPPK-së në disa pjesë të saj përkatëse thotë si vijon:

- 1) *Gjykata e shkallës së dytë, duke miratuar ankesën..., me aktvendim anulon aktgjykimin e shkallës së parë dhe çështjen e kthen në rigjykim kur vërteton se ekziston shkelle esenciale e dispozitave të procedurës penale, përveç rasteve nga ... neni 426, paragrafi 1 i këtij Kodi, si dhe kur vërteton se për shkak të vërtetimit të gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike duhet urdhëruar shqyrtim të ri gjyqësor në gjykatë të shkallës së parë.*
- 2)....
- 3)
- 4) *Kur arsye e vetme për anulim të aktgjyimit të gjykatës së shkallës së parë është vërtetimi i gabueshëm i gjendjes faktike dhe për vërtetim të drejtë të gjendjes faktike kërkohet vlerësim tjetër i fakteve të vërtetuara pa mbledhur prova të reja apo pa përsëritur provat e shqyrtuara, gjykata e shkallës së dytë nuk anulon aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, por vepron sipas nenit 426 të këtij Kodi.*

Neni 426 i KPPK-së si relevant në lëndën në fjalë përcakton si në vijim:

- 1) *Gjykata e shkallës së dytë, duke e aprovuar ankesën ... e ndryshon aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë me aktgjykim kur vërteton se faktet vendimtare në aktgjykimin e shkallës së parë janë vërtetuar drejt, porse duke marrë parasysht gjendjen e vërtetuar faktike sipas zbatimit të drejtë të ligjit është dashur të merret aktgjykim tjetër.[...]*
- 2)...

29. Gjykata e shkallës së dytë në arsyetimin e saj nën pikën “vërtetimit të gabueshëm dhe jo të plotë të gjendjes faktike”ka nxjerr në pah se nuk e ndan vlerësimin e gjyqtarit të parë dhe kështu që pika përkatëse e ankesës siç është bërë nga mbrojtja e **Shyqeri Shalës** ishte menduar të jetë e bazuar. Në veçanti, vlerësimi i deklaratave të dëshmitarit N



që janë kryer prej gjykatës së shkallës së parë mund të jenë të diskutueshme. Veç kësaj, disa dëshmi të hollësishme siç janë ato në veçanti të telefonatës së pranuar nga gazetari Q dy ditë pas krimeve e gjithashtu edhe deklaratat e disa dëshmitarëve që i pandehuri **Shyqeri Shala** është parë në në pasditën e të njëjtës ditë kur krimet ishin kryer, nuk do të ishte dëshmi e mjaftueshme për dënimin e secilit veç e veç, përkundër faktit që prania e të pandehurit **Shyqeri Shala** saktësisht në kohën e vrasjes nuk është vërtetuar përtej të gjitha dyshimeve.

30. Deri më tani, adresim është bërë në atë që është thënë më parë në lidhje me vendimin e gjykatës së shkallës së dytë nën pikën A.I., fq. 9 dhe 10, pika 24, e këtij aktgjykimi.

31. Nga e tërë kjo mund të kuptohet që gjykata e shkallës së dytë ka zbatuar nenin 424 paragrafin 2 në lidhje me nenin 426 paragrafin 1 të KPPK-së, kështu që duke marr parasysh se gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar faktet materiale në mënyrë të rregullt, por që vërtetimi i rregullt i gjendjes faktike do të kërkonte vlerësim të ndryshëm të fakteve tashmë të vërtetuara. Pas asaj që është thënë më parë në parimin *in dubio pro reo* në lëndën në fjalë, Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se gjykata e shkallës së dytë në mënyrë të rregullt ka aplikuar dispozitat përkatëse të KPPK-së, pasi që lënda në fjalë me të vërtetë do të duhej të përshihej nën nenin 424 paragrafin 4 e lidhur me nenin 426 paragrafin 1 të KPPK-së.

## **B. Përfundim i Gjykatës Supreme të Kosovës**

32. Për shkak të arsyeve të lartpërmendura, Gjykata Supreme përfundon se Kërkesa për Mbrojtje të Ligjshmërisë nga ZPShK-së është e pabazuar.

33. Për shkak të arsyeve të lartpërmendura Gjykata Supreme vendosi si në dispozitiv, në pajtim me nenin 457 paragrafit 2 të KPPK-së.



GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHË INË  
PKL.-KZZ. nr. 82/2010, 25 janar 2011

Anëtar i Kolegjit

**Charles L. Smith III.**

Kryetari i Kolegjit

**Gerrit-Marc Sprenger**

Anëtare e Kolegjit

**Emine Mustafa**

Anëtare e Kolegjit


**Nesrin Lushta**

Anëtar i Kolegjit

**Salih Toplica**

Procesmbajtësi

**Holger Engelmann**



Republika e Kosovës / Republika Kosovo  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHË INË  
KOSOVO / KOSOVO

Procesmbajtës  
Holger Engelmann

